



Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
VENDIMIN
PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DEVOLL, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË”, Z. ALFREDI PETRI GJATA

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 1789 prot., datë 03.06.2024, Këshilli i Bashkisë Devoll, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Ylver Gurtali Bylykbashi, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Devoll, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 11, z. Alfredi Petri Gjata.

Me shkresën nr. 1690, prot., datë 24.06.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Devoll z. Alfredi Petri Gjata, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër KO-PS-23605_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Alfredi Petri Gjata, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 1795 prot., datë 02.07.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr. 1796

prot., datë 02.07.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për z. Alfredi Petri Gjata.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Alfredi Petri Gjata, në këshillin e bashkisë Devoll.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 11293/1 prot., datë 05.07.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Alfredi Petri Gjata, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Alfredi Petri Gjata, në Këshillin e Bashkisë Devoll, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Pavlina DOÇAJ - Shef sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Madalena KOJA - Drejtoria e Ligjshmërisë

Jona JOSIFI - Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DEVOLL, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË”, Z. ALFREDI PETRI GJATA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1789 prot., datë 03.06.2024, këshilli i bashkisë Devoll, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Ylver Gurtali Bylykbashi, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Devoll, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 11, z. Alfredi Petri Gjata.

Me shkresën nr. 1690, prot., datë 24.06.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Devoll z. Alfredi Petri Gjata, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: .2024 Nr: 123456
Ora:



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë” z. Alfredi Petri Gjata.”

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër KO-PS-23605_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Alfredi Petri Gjata, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 1795 prot., datë 02.07.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr. 1796 prot., datë 02.07.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për z. Alfredi Petri Gjata.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Alfredi Petri Gjata, në këshillin e bashkisë Devoll.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 11293/1 prot., datë 05.07.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Alfredi Petri Gjata, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Alfredi Petri Gjata, në Këshillin e Bashkisë Devoll, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Alfredi Petri Gjata.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Iirjan CELIBASHI

